

LIGJI Nr.10 341, datë 28.10.2010
PËR STANDARDIZIMIN USHTARAK NË FORCAT E ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për:

- a) organizimin dhe funksionimin e sistemit të standardizimit ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
- b) përcaktimin e strukturave dhe të përgjegjësive të tyre;
- c) dhënien e fuqisë autoritetit më të lartë për pranimin e marrëveshjeve të standardizimit STANAG/AP të NATO-s dhe të standardeve për përdorim nga njësitë e Forcave të Armatosura në fushën operacionale, materiale e administrative.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit ligjor për standardizimin ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përfshirë procedurat e nevojshme për përzgjedhjen, pranimin, publikimin e zbatimin e marrëveshjeve të standardizimit STANAG/AP-ve të NATO-s dhe të standardeve civile për përdorim nga njësitë e Forcave të Armatosura.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Standardizim" është zhvillimi dhe zbatimi i koncepteve, i procedurave dhe i rregullave të përbashkëta, me synimin për të zhvilluar e për të mbajtur kapacitetet e duhura operacionale në tri nivelet e standardizimit në fushën ushtarake; të përafrueshmërisë, të ndërkëmbyeshmërisë, të përputhshmërisë, në fushat e operacioneve, të procedurave, të materialeve, si dhe ato teknike e administrative, për të arritur ndërveprimin optimal të tyre.
2. "Marrëveshje standardizimi (STANAG)" është arritja e një marrëveshjeje ndërmjet disa shteteve ose të gjitha shteteve anëtare të Aleancës, për të adoptuar përdorimin e pajisjeve ushtarake të njëjta ose të përafërta, përfshirë municione, materiale furnizimi dhe rezerva, si dhe të procedurave operacionale, logjistike dhe administrative të njëjta. Pranimi nga vendet pjesëmarrëse i një publikimi të Aleancës nga Agjencia e NATO-s për Standardizimin emërtohet si një marrëveshje standardizimi.
3. "Përafrueshmëria" është ngjashmëria e produkteve, proceseve ose e shërbimeve që ofrohen për përdorim të përbashkët, nga vendet e Aleancës, në kushte të caktuara, për të përmbushur kërkesa të paracaktuara, pa shkaktuar efekte të padëshiruara.
4. "Ndërkëmbyeshmëria" është aftësia e një produkti, e një procesi ose e një shërbimi, për t'u

përdorur në mënyrë të shkëmbyeshme në vend të një produkti, procesi a shërbimi tjetër që përmbush kërkesa të njëjta.

5. "Përputhshmëria" është gjendja fundore e arritur kur vendet përdorin doktrina, procedura ose pajisje të njëjta.

6. "Publikimi i Aleancës (AP)" është dokumenti zyrtar i standardizimit në NATO, për të cilin disa ose të gjitha vendet e NATO-s bien dakord ta përdorin, si një dokument autoritar të zbatimit të përbashkët, dhe që u jepet për zbatim të gjithë përdoruesve të të gjitha niveleve.

7. "Autoriteti propozues i STANAG-ut" është komanda/drejtoria/institucioni që propozon fillimin e procesit të ratifikimit të një STANAG-u.

8. "Autoriteti kujdestar" është komanda/drejtoria/institucioni që nis procesin e ratifikimit të një STANAG-u/AP-je.

9. "Grupi i ekspertëve" është një organizëm ose një grup pune në varësi të një autoriteti kujdestar, të cilit i jepet detyrë nga ky i fundit për zhvillimin e projekteve të dokumenteve normative të standardizimit.

10. "Personi përgjegjës i standardizimit" është personi mbikëqyrës dhe që shërben si pikë kontakti për zhvillimin e projekteve të dokumenteve normative të standardizimit. Ai është, në përgjithësi, kryetari i grupit të ekspertëve për vlerësimin, zbatimin dhe rishikimin e tyre.

11. "Raporti i vlerësimit" është një raport i hollësishëm i vlerësimit për secilin STANAG/AP, që shpreh implikimet e mundshme strukturore e infrastrukturore të pajisjeve e të sistemeve, të trajnimit e të arsimimit, të koncepteve e doktrinave, si dhe ato financiare për zbatimin e tij në një periudhë kohore të caktuar.

12. "Propozimi" është faza e fillimit për përpunimin e një STANAG-u. Propozimet e standardizimit i paraqiten, nga vendet dhe organizmat e NATO-s, autoritetit përgjegjës të detyrës, duke përdorur një formular të standardizuar.

13. "Pranimi" është deklarimi, me anë të cilit një vend i NATO-s pranon zyrtarisht, me ose pa rezerva, përbajtjen e një marrëveshjeje standardizimi të NATO-s (STANAG).

14. "Shpallja" është një deklarami zyrtar nga autoriteti kompetent, i cili i jep STANAG-ut një efekt zbatimi në të gjitha vendet e NATO-s. Shpallja bëhet nga Drejtori i Agjencisë së NATO-s për Standardizimin (NSA) kur plotësohen kushtet e tij.

Neni 4

Qëllimi i veprimtarisë së standardizimit ushtarak në Forcat e Armatosura

Qëllimi i standardizimit ushtarak është pranimi dhe zbatimi nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë i standardeve të NATO-s dhe i standardeve civile për përdorim nga njësitë e Forcave të Armatosura, për të siguruar rritjen e ndërveprimit ndërmjet llojeve të forcave e të shërbimeve brenda Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të Aleancës.

Neni 5

Autoritetet, organizmat e standardizimit ushtarak në Forcat e Armatosura dhe përgjegjësitë kryesore të tyre

1. Ministri i Mbrojtjes është autoriteti më i lartë civil në sistemin e standardizimit në Forcat e Armatosura. Ai përgjigjet, në emër të Republikës së Shqipërisë, për miratimin e politikave të zhvillimit të standardizimit në Forcat e Armatosura dhe pranimin e STANAG-ut/AP-ve të NATO-s.

2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është autoriteti më i lartë ushtarak, që përgjigjet për funksionimin e sistemit të standardizimit në Forcat e Armatosura.

3. Bordi i standardizimit në Ministrinë e Mbrojtjes është organ i posaçëm (ad hoc), i cili

shqyrton, për t'u miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, planet për pranimin e standardeve të NATO-s, të standardeve civile për përdorim nga njësitë e Forcave të Armatosura, si dhe praktikat dokumentare të paraqitura nga organizmat e përcaktuar në sistemin e standardizimit në Forcat e Armatosura. Planet për pranimin e STANAG-ut/AP-ve i propozohen Ministrit të Mbrojtjes nëpërmjet Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të bordit të standardizimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 6

Planifikimi i standardizimit ushtarak në Forcat e Armatosura

1. Standardizimi është përgjegjësi e strukturave dhe e komandave të të gjitha niveleve, për të përmbushur misionin tyre, i cili bazohet në objektivat parësorë të zhvillimit të forcës përkatëse.
2. Bordi i standardizimit ia dërgon për miratim Ministrit të Mbrojtjes planin e standardizimit në Forcat e Armatosura, ku përcaktohen:
 - a) autoriteti kujdestar;
 - b) afatet e përfundimit të raportit të vlerësimit të STANAG-ut/AP-ve;
 - c) gjuha, sipas së cilës zbatohet STANAG-u/AP-ja.

Neni 7

Pranimi i STANAG-ut/AP-së të NATO-s dhe standardeve civile për përdorim nga njësitë e Forcave të Armatosura

1. Autoriteti kujdestar, në bazë të planit të standardizimit të Forcave të Armatosura, nis punën për studimin e pranimin e STANAG-ut/AP-së, sipas procedurave dhe dokumentacionit përkatës të NATO-s.
2. Autoriteti kujdestar i STANAG-ut/AP-së cakton grupe ekspertësh për vlerësimin dhe për përcaktimin e statusit të pranimit të tij. Kryetari i grupit të ekspertëve është personi përgjegjës i STANAG-ut/AP-së dhe njihet në NATO si pikë kontakti e vendit për këtë marrëveshje standardizimi.
3. Grupet e ekspertëve hartojnë raportin e vlerësimit të STANAG-ut/AP-së, i cili, sipas procedurave të përcaktuara nga Ministria e Mbrojtjes, diskutohet në bordin e standardizimit dhe pranohet nga Ministri i Mbrojtjes.
4. Në rastet kur gjykohet e nevojshme nga personi përgjegjës i standardizimit dhe autoriteti kujdestar, raporti i vlerësimit të STANAG-ut/AP-së dërgohet për mendim në ministritë dhe zyrat e tjera administrative, të cilat janë të detyruara t'ia dërgojnë opinionin e tyre përdoruesit brenda afateve ligjore. Nëse ky opinion nuk është dërguar nga ministritë dhe zyrat e tjera administrative brenda afatit, do të vlerësohet se ato janë dakord me standardin e propozuar.
5. Format i pranimit të STANAG-ut/AP-së duhet të përmbajë:
 - a) titullin dhe shënimin e STANAG-ut/AP-së (numri; botimi-muaji-viti; titulli, në anglisht);
 - b) përkthimin e titullit të origjinalit;
 - c) vendimin e miratimit në bordin e standardizimit;
 - ç) shenjën e referencës S.U.SH. STANAG/AP XXXX (S.U.SH - Standard Ushtarak Shqiptar).

Neni 8

Shpallja e STANAG-ut/AP-së të pranuar

1. Miratimi nga Ministri i Mbrojtjes i dokumentacionit dhe i vendimit të bordit të standardizimit është pranimi zyrtar i STANAG-ut/AP-së nga Forcat tona të Armatosura.

Shpallja e STANAG-ut/AP-së të pranuar bëhet:

- a) në NATO, nga Përfaqësia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë;
 - b) në Forcat tona të Armatosura, nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, nëpërmjet planit të veprimit për zbatimin e STANAG-ut/AP-së, i cili duhet të përmbajë detyrimet për angazhimet e mundshme, kohën e zbatimit, strukturat përgjegjëse dhe ato bashkëpunuese.
2. Për STANAG-un/AP-në e pranuar, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura përcakton rregullat dhe strukturën përgjegjëse për regjistrimin dhe arkivimin e tyre.

Neni 9

Konfirmimi për zbatimin e STANAG-ut/AP-së

Autoriteti kujdestar i STANAG-ut/AP-së dhe personi përgjegjës i standardizimit ndjekin punën për zbatimin e tij, sipas afateve të përcaktuara. Konfirmimi për datën e zbatimit të STANAG-ut/AP-së bëhet në NATO nga Ministria e Mbrojtjes (pas raportimit të personit përgjegjës dhe autoritetit kujdestar) në gjuhën angleze, sipas modeleve të përcaktuara për këtë qëllim.

Neni 10

Shpenzimet e procesit të zbatimit të STANAG-ut/AP-së mbulohen nga propozuesi, nëpërmjet sistemit të planifikimit dhe zhvillimit të forcës.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrt are.

Shpallur me dekretin nr.6762, datë 10.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi